


Sa ka perspektivë një i ri në Kosovë?



Besim Kuçi

Rinia kosovare po vazhdon të mbetet akoma aseti kryesor kombëtar krahasuar me vendet tjera evropiane. Ndërsa për shoqërinë tonë po vazhdon të mbetet sfida kryesore për gjetjen e një perspektive dinamike. Vendi ynë i dalë nga lufta para 18 vjetësh ka një përballje jo të lehtë për ta kapërcyer tranzicionin ekonomik, social, kulturor e politik. Tranzicioni i tejzgjatur, izolimi ndërkombëtar, mungesa e traditës shtetformuese, një ekonomi që përkundër përpjekjeve të suksesshme në dy-tri vitet e fundit akoma ndodhet në tranzicion. Me një edukim jo shumë konkurrues, një demokraci traditëshkurtër, sikur kanë krijuar një ambient mjaft të vështirë në vendin tonë. Andaj siç duket për rininë tonë është mjaft sfiduese për ta pasur një perspektivë të standardeve evropiane. Në anën tjetër Kosova, një vend i pasur me resurse natyrore, me një pozitë strategjike në rajon, me një rini mjaft energjike, sikur e bën më shpresëdhënëse perspektivën e dëshiruar. Mjafton vullneti i mirë dhe këmbëngultësia për t'i hapur shtigjet e reja të suksesit dhe për t'i vënë në lëvizje të gjithë mekanizmat relevantë për ta mundësuar përparimin.

Shqetësimet e të rinjve kryesisht ndërlidhen me nivelin e sistemit arsimor në Kosovë, pastaj paraqitjen e problemeve që kanë të bëjnë me tregun e punës si pasojë e mungesës së programeve edukative për orientim profesional gjatë viteve të shkollimit. Po ashtu edhe vështirësitë financiare që ata ballafaqohen gjatë studimeve dhe pas tyre si pasojë vonesës së punësimit ose edhe e mospasjes mundësi për t'u punësuar në drejtimet përkatëse. Disa prej tyre megjithatë manifestojnë një optimizëm për perspektivë në Kosovë, duke pasur parasysh kapacitetet ekonomike dhe mundësitë për punësim. Ka edhe të tjerë që e kritikojnë më së shumti klasën politike në përgjithësi për situatën e krijuar dhe për mungesën e një perspektive optimiste në vend, duke potencuar se bota perëndimore mund të ofrojë perspektivë më të mirë për ta. Perspektiva e një të riu në komunën e Suharekës nuk mund të veçohet shumë nga ajo e të rinjve në qytetet tjera të Kosovës. Megjithatë, rrethanat socio-ekonomike në komunën e Suharekës kanë karakteristika e veta si:

Sallonet e së Martes janë një numër i vogël i institutit Dentekriaci për Zhvillim (D4D). Sallonit ka format gjysmeforrnal sipas regullës "Chatnam House" dhe pa prani të medieve Diskutimi mbledh rreth vetes ekspertë e analistë politikane e publicistë për të reflektuar dhe kërkuar konsensus rreth temat e për zgjedhura. Fala e hapjes postohet në kanalën e salloneve në "You-Tube". Secili Sallon përcillet me editorial që publikohet në "Zeri" të martën e ardhshme dhe në faqen elektronike të D4D-së. Podcastet bazuar në editorial mund t'i gjeni në uebfaqen tone.

mundësitë për zhvillimin e turizmit rural, mundësitë për zhvillimin e trashëgimisë kulturore, shtimi i kompanive prodhuese që tashmë kanë plasuar produktet e tyre edhe në tregun ndërkombëtar. Duhet të konsiderohen po ashtu edhe mundësitë për shtimin e kompanive prodhuese në zonën industriale e gjetiu. Po ashtu duhet konsideruar edhe zhvillimin i infrastrukturës pasi që ka lehtësuar mjaft shumë qarkullimin e lëvizjes dhe ka ndikuar që të ngadalësohet migrimi nga fshati në qytet. Të rinjtë duhet më shumë të inkurajohen që të ndërmarin iniciativa kreative për të kontribuar në ndërtimin e një perspektive të shëndoshë dhe të suksesshme për veten dhe vendin e tyre, duke u sugjeruar që mos të orientohen vetëm nga bota perëndimore, por edhe këtu në vendin tonë. Ndërkaq theks të veçantë duhet vënë edhe tek angazhimi i rinisë në shoqërinë civile në të cilën do të jenë më afër ideve krijuese dhe informimit me aktivitetet e shumta që ndodhin në shoqëri. Në vendet perëndimore të rinjtë janë pjesë e pandashme e OJQ-ve dhe në këtë mënyrë janë në kohezion me trendin e zhvillimeve të përgjithshme. Shqetësim tjetër në vendin tonë është gjendja e vështirë sociale që mbizotëron në disa familje, në të vërtetë paraqet vështirësi për një perspektivë më të mirë për të rinjtë e këtyre kategorive, ngase atyre duke u përpjekur për mbijetesë u zvogëlohen mundësitë për të qenë koherentë me proceset bashkëkohore.

Në kuadër të gjërave që mund të ndërmerren për ta krijuar një perspektivë në Kosovë janë edhe çështjet që kanë të bëjnë me politikën dhe arsimimin. Një reformim i mjaftueshëm i skenës politike me personalltete dhe ekspertë të shkolluar jashtë vendit, profesionistë e të pakorruptuar vendin tonë do të mund ta vinte në binarë të zhvillimit. Pastaj një reformim i duhur i sistemit arsimor do të vinte në baraspeshë numrin e kuadrove në proporcion me tregun e punës. Prandaj mesazhi i të rinjve sot është më shumë njëri që të ditur, më shumë përgjegjësi, më shumë sundim të rendit dhe ligjit, sepse këto do ta mundësonin zhvillimin, përparimin dhe integrimin e vendit si dhe do ta krijojnë perspektivën në ata ëndërrime.